



QËNDRA PËR QEVERISJE TË MIRË



Raport i shkurtuar mbi Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Kuçovë.
Mbështetur nga LËVIZALBANIA.

A	Të përgjithshme
	<p>1)-Qendra për qeverisje të mirë (QQM), me mbështetjen e donatorit “LëvizAlbania” dhe në bashkëpunim me shoqatat “Gruaja Naftëtare në Fokusin e Zhvillimit” “Klubi Rinor Ambientalist Blerimi”, “Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare” dhe Dega “Amaro –Drom”, ka hartuar këtë raport të shkurtuar mbi menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Kuçovë bazuar në tre burime kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none">-Informacionin e marrë prej bashkisë;-Të dhënat e përftuara nga vëzhgimi në terren;-Të dhënat nga anketimi i 320 banorëve të bashkisë ku u përfshinë banorë me moshë nga 16 deri në 80 vjeç me pjesmarrje të nxënësve, studentëve, fermerëve, të vetpunësuarve, pensionistëve etj... si edhe 109 persona të papunë. Gjithashtu raporti meshkuj femra ishte 50% me 50%. <p>2)-Aktualisht shërbimi kryhet nga Shoqëria “Higjena” sh.p.k ,me kontratë deri Qershor 2017 me një fond prej 32,009,320 lekë . Mbi 50% e këtij fondi përfitohet nga tarifa e mbledhur prej bizneseve, institucioneve dhe familjeve që u ofrohet ky shërbim.</p>
B	Përshkrim i ofrimit të shërbimit
	<p>1)-Mbetjet urbane në bashkinë Kuçovë grumbullohen në mënyrë tradicionale të pandara dhe më pas transportohen në fushën e depozitimit të mbetjeve e cila ndodhet në buzë të lumit Devoll, në kushte jo të mira teknologjike duke krijuar rrezik të dukshëm për jetën e individëve brenda dhe përtej territorit të bashkisë Kuçovë.</p> <p>2)-Përpunimi i materialeve të hedhura kryhet me traktor të vjetër dhe të arnotizuar dhe mbledhja për riciklimin bëhet kryesisht në fushën e depozitimit nga njerëz në nevojë dhe të pa autorizuar. Në shkarkimet ujore vihet re një prani e naftës bruto që derdhet nëpër kolektorin kryesor të ujrave të zeza apo kanaleve të tjera dhe përfundon në lumin Seman.</p> <p>3-Në periudhën 2016-2017 shërbimi ofrohet pothuajse në të gjithë territorin e bashkisë duke përfshirë edhe njësinë administrative Lumas ku janë</p>

	<p>vendosur në total 12 kontenierë me praktikë shërbimi dy herë në javë. 4)- Nuk ka nisma, insiativa dhe procese të ndarjes së mbetjeve në burim shumica e mbetjeve nuk trajtohen në vendin e depozitimit i cili nuk plotëson kushtet sipas standarteve bashkëkohore. Aktualisht nuk ka sasi të mbetjeve urbane që ndahen e shkojnë për kompostim dhe nuk ka plan vendor të mbrojtjes së mjedisit.</p> <p>4)-Bashkia ka hartuar e miratuar Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Këshilli Bashkiak ka kryer miratime të arsyetueshme të akteve rregullatore në drejtim të menaxhimit të mbetjeve. Titullari i bashkisë ka qënë i suksesshëm pasi ka punuar me kujdes për të gjetur mbështetje dhe mirëkuptim me Këshillin Bashkiak.</p>
C	Vendi i grumbullimit të mbetjeve
	<p>1)-Vendi i grumbullimit përfundimtar dhe i sistemimit të mbetjeve është në fshatin Rreth Tapi, në një sipërfaqe rreth 12 500 m². Territori është i pa rrethuar, gjendet një mal me mbetje të pandara që shkaktojnë ndotje mjedisore në tokë dhe nga ana tjetër djegjet nga persona të papërgjegjshëm vazhdojnë të shkaktojnë ndotje në ajër.</p> <p>2)-Në vend-depozitim bëhet trajtim i mbetjeve me një traktor me thikë e zinxhirë i planifikuar vetëm për 65 ditë në vit. Shpesh herë qytetarë të papërgjegjshëm ndezin zjarr ose i përhapin mbetjet dhe marrin atë që duan. Nga anketimi rezulton se 55% e qytetarëve të pyetur kanë parë që kryhet djegje në ambient të hapur dhe tymi që del prej djegjes përhapet gjithandej.</p> <p>4)-Toka ndotet pasi ka rrjedhje sepse nuk janë zbatuar kushtet e ndërtimit të një “landfilli” me kushte bashkëkohore.</p>
D	Mjetet, proceset dhe punonjësit
	<p>1)-Gjëndja e kontenierëve në qendër të qytetit në përgjithësi është e mirë, ndërsa në vendbanimet përreth qendrës ka nevojë për përmirësim, dhe në zona të thella ka nevojë për ndryshime rrënjësore.</p> <p>2)-Ka tre mjeteve kryesore transportuese; ato janë të vjetra dhe kërkojnë ndërhyrje riparimi të shpeshta; nuk kanë “kod” ose “numër”. Çdo mjet lëviz mesatarisht 8.75 km për çdo ditë, sasia e mbetjeve është 26.8 ton/ditë.</p> <p>3)-Punonjësit janë vlerësuar të aftë për kryerjen e proceseve të punës por ka raste që nuk zbatojnë rregulloren, hipin makinës në ecje e sipër ; qëndrojnë afër kur kamioni vetëshkarkon kontenierin; nuk përdorin rregullisht maska e</p>

	<p>mjete të tjera mbrojtëse etj...</p> <p>4)-Instruktimi i punëtorëve bëhet rregullisht çdo tre muaj, ku pas instruktimit çdo punëtor firmos në kartelë, por ka vend edhe për përmirësim të mëtejshëm në zbatimin e zotërimin e proceseve të punës.</p> <p>5)-Grafikët zbatohen në varësi të situatës; punohet 6 ditë në javë; vetëm dita e dielë është pushim. Koha e punës shfrytëzohet nga të gjithë punëtorët. Veshjet e punonjësve janë shumë të vjetëruara dhe të njëjtat veshje përdoren si në dimër ashtu edhe në verë. Mungon karta i identifikimit që tregon se individi i punësuar është punonjës pastrimi.</p> <p>6)-Është vetëm një kontrollor për të gjithë zonën i cili nuk mund të kontrollojë veprimtarinë në një territor kaq të madh edhe pse dokumentacioni i mbajtur u gjend i rregullt.</p>
E	Buxheti dhe tarifa
	<p>1)-Për vitin 2016-2017, buxheti i shërbimit është miratuar afërsisht 50% më shumë se më parë, por popullsia e bashkisë është pothuajse dyfishuar dhe ka sipërfaqe shumë më të madhe shërbimi.</p> <p>Buxheti për 27.06.2016 deri 27.06.2017 është vendosur me shumën 32,009,320 lekë. Më shumë se gjysma e të anketuarve (175 prej tyre), të cilët përbëjnë 54 % e banorëve, nuk kanë njohuri mbi buxhetin e bashkisë në tërësi.</p> <p>2)-Realizimi i të ardhurave bazohet në miratimin e tarifave sipas vendimit përkatës të Këshillit Bashkiak, të miratuar për paketën fiskale të vitit 2017. Vetëm 3% e banorëve kanë dijeni për fondin që shpenzon bashkia për shërbimin dhe vetëm 9% e tyre janë dakord për shtimin gradualisht të pagesës së sasisë së tarifës së miratuar.</p> <p>3)-Sipas anketës vërehet se 20 % e të anketuarve e pranojnë në mënyrë direkte apo indirekte se nuk e paguajnë tarifën e pastrimit dhe më shumë se 50% prej tyre nuk kanë dijeni për mënyrën dhe sasinë që duhet paguaj një banor në muaj për menaxhimin e mbetjeve.</p>
F	Angazhimi komunitar
	<p>1)-Një pjesë e madhe e komunitetit (62,5 %) nuk përfshihet në vendimmarrje dhe më shumë se gjysma e ndjejnë veten të pa mbrojtur nga dëmi që mund të shkaktojnë mbetjet, dhe 47 % e popullatës reagojnë për ndotjen e mjedisit. Vetëm 25 banorë apo 7.9% të popullatës, kanë marrë pjesë në mbledhjet e</p>

	<p>Këshillit Bashkiak dhe 36 % e tyre nuk janë në dijeni mbi vendimet dhe masat që merr bashkia. Vetëm 37% e të anketuarve kanë marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga shoqëria civile për pastrimin e mbetjeve dhe 73% kanë marrë pjesë vullnetarisht për pastrim rretheqark vendbanimit të tyre.</p> <p>2)-Ndotësit kryesorë janë banorët, institucionet dhe bizneset dhe 60% e të anketurve e pranojnë sjellja e tyre duhet përmirësuar. Marrjen e informacionit dhe edukimin qytetar banorët e shikojnë nëpërmjet radios e televizionit , rrjeteve sociale, faqes ëeb të bashkisë dhe komunikimeve midis palëve të përfshira .</p> <p>Qytetarët mendojnë se mënyra më e mirë për të bashkëbiseduar me ata në përmirësimin e shërbimit të pastrimit janë mbledhjet e hapura si në për lagje ashtu edhe nëpër shkolla.</p>
G	Perspektiva
	<p>1)-Shpresa për të ardhmen, se shërbimi do të rregullohet paraqitet si vijon: 7% e të anketuarve janë të pashpresë se do të ketë ndryshim, 58% prej tyre mendojnë se ndryshimet do të jenë të pakta dhe të mjaftueshme dhe 35% se do të bëhet më mirë dhe shumë më mirë. Shërbimi ka diferenca të theksuara midis zonës së qendrës, vendbanimeve periferike dhe zonave të thella rurale.</p> <p>2)-Opinionin në përgjithësi i komunitetit mbi nivelin e heqjes transportimit dhe trajtimit në vend-depozitim në bashkinë Kuçovë prej 320 individëve të anketuar, është i tillë: 136 prej tyre apo 43% vlerësojnë se shërbimi është i dobët apo i mjaftueshëm ; 161 prej tyre apo 50% e vlerësojnë se është i mirë dhe 23 prej të anketuarve apo 7% e vlerësojnë shumë të mirë.</p> <p>3)-Për nivelin e shërbimit të pastrimit në afërsi të vendbanimit të tyre banorët dhanë këto shifra: 127 banorë apo 29% e vlerësojnë të dobët e të mjaftueshëm; 174 banorë apo 55% të tyre e konsiderojnë të mirë dhe 19 të anketuar apo 6% e vlerësojnë shumë të mirë.</p> <p>4)-Mbi 70% e personave të pyetur, rezulton se pikat më shumë të ndotura që ndikojnë mbi shëndetin e qytetarëve të bashkisë janë kazanët e papastër dhe vendi i grumbullimit të mbetjeve në Rreth Tapi.</p>